

NJOFTIM PUNËSIMI

Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	<p>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë. Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësojë <u>për një vende pune: Punonjës Depo dhe Rrjeti Fushë - Krujë pranë Shpërndarjes në Njësinë Operative Krujë</u> nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për garantimin e funksionimit normal të depos së re të ujit dhe rrjetit të rehabilituar të furnizimit me ujë në zonën e Fushë-Krujës, nëpërmjet monitorimit, kontrollit dhe mirëmbajtjes operative të elementeve të sistemit.</p>
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	<ul style="list-style-type: none">• Monitorimin e vazhdueshëm të objekteve të furnizimit, kontrollin e rrjetit të ujësjellësit, evidentimin në kohë të problematikave dhe mbështetjen e ndërhyrjeve për garantimin e furnizimit të pandërprerë me ujë.• Monitoron gjendjen operative të depos së ujit;• Kontrollon nivelin e ujit dhe parametrat bazë të funksionimit;• Kryen kontrole periodike në objektet e furnizimit;• Monitoron gjendjen e rrjetit të ujësjellësit;• Evidenton rrjedhjet, defektet apo problematikat në terren;• Raporton problematikat tek strukturat përgjegjëse;

	<ul style="list-style-type: none"> • Ndihmon në realizimin e ndërhyrjeve operative; • Bashkëpunon me ekipet e mirëmbajtjes dhe manovrimit të rrjetit. • <u>Shtesë</u>: Në vijim të zhvillimit të aktivitetit, zgjerimit të rrjetit, ndryshimit të regjimeve të furnizimit ose nevojave operative të zonës, punonjësi mund të angazhohet edhe me detyra të tjera që lidhen me administrimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë.
Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:	<ul style="list-style-type: none"> • Eksperienca pune të mëparshme. • Librezë e Punës • Certifikatë Familjare • Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës • Dy fotografi • Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar • Dëshmi Penaliteti • Raporti Mjekësor • Vërtetim Vendbanimi
Kushtet e punës:	<ul style="list-style-type: none"> • Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. • Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.
<ul style="list-style-type: none"> • Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 09.07.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar. 	